



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

WWRO/STO/WC-11/2006
31 Maj 2006

URDHËRESË E TARIFAVE TË SHËRBIMIT

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE QË DUHET TË APLIKOHEN NGA KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “HIGJIENA” GJILAN

Në pajtim me autoritetin e dhënë me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49 *mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave* të datës 26 nëntor 2004 (“Rregullorja”)

Konform me Nenin 26 të Rregullës *mbi Rregullimin e Tarifave për Shërbime nga Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Kosovë* të datës 26 janar 2005 (“Rregulla e ZRRUM R 02/SWC”),

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (“ZRRUM”) me anë të kësaj nxjerr si vijon:

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që iu atribuohet në Rregullën e ZRRUM - R 02/SWC.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për KRM “HIGJIENA”, Gjilan që me këtë kërkohet të veprojë në pajtim me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit me rastin e faturimit të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave që u ofron konsumatorëve të vet në tërë Zonën e Shërbimit.

3. Lista e Tarifave të Shërbimit

- 3.1 . Për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave që iu ofron konsumatorëve të vet KRM “HIGJIENA” duhet të aplikojë tarifën e shërbimit të dhëna në Shtojcën 1 të kësaj Urdhërese të Tarifave të Shërbimit.
- 3.2 . Për shërbimet e pastrimit të rrugëve KRM “HIGJIENA”, do të aplikojë tarifën të cilat kanë qenë në fuqi në vitin 2005 në bazë të kontratës me Kuvendin Komunal. Këto

tarifa do të jenë në fuqi përderisa nuk zëvendësohen me tarifa të reja të nxjerra nga ZRRUM-i.

- 3.3 . Për shërbimet tjera që kryen KRM “HIGJIENA”, e të cilat nuk janë përfshi nën 3.1. dhe 3.2., faturimi do të bëhet me tarifatat që janë kalkuluar në bazë të kostove reale nga KRM “HIGJIENA” dhe të cilat janë të aprovuara nga ZRRUM.

4. Afati

Tarifatat e Shërbimit të aprovuara me anë të kësaj Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të hyjnë në fuqi duke filluar prej **1 Qershorit 2006** dhe do të jenë në fuqi **deri më 31 Maj 2007**.

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

- 5.1. KRMH “UNITETI” do të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit tek secili Konsumator në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në vit bashkangjitur me Faturë.
- 5.2. Lista e Tarifave të Shërbimit e aprovuar nga ZRRUM nën këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të publikohet nga KRM “HIGJIENA” në së paku njërin prej gazetave ditore me tirazh gjithëpërfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) Ditëve të Punës pas shpalljes dhe publikimit nga ana e ZRRUM-it në ueb-faqen zyrtare të ZRRUM-it.

6. Apelet

KRM “HIGJIENA” në rast të pakënaqësisë me dispozitat e kësaj Urdhërese të Tarifave të Shërbimit ka të drejtë të apelojë tek Komisioni Shqyrtues që themelohet konform Rregullores së ZRRUM-it.

7. Gjuha Zyrtare e Urdhrit të Tarifave për Shërbime

Urdhri për Tarifa të Shërbimeve nxjerrët dhe publikohet në tri (3) versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë: (i) Shqip, (ii) Serbisht dhe, (iii) Anglisht. Në rast të mospërputhjeve në mes të versioneve, do të mbizotërojë ai në gjuhën Angleze.

Afrim Lajçi
Drejtore i ZRRUM

SHTOJCA 1:
LISTA E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE

1. Kategoria e Konsumatorëve Shtëpiak		
Mënyra e ofrimit të shërbimit	Derë-me-derë	Me kontejnerë të përbashkët
Tarifa (EURO/muaj)	3.74	3.74

2. Kategoria e Konsumatorëve Komercial/Industrial			
2.1. Shërbimet e Ofruara me Kontejnerë të Përbashkët			
Nën-kategoria	<u>Nën-Kategoria 1</u>	<u>Nën-kategoria 2</u>	<u>Nën-kategoria 3</u>
	Veprimtaritë e vogla zeytare dhe shërbyese (Kioska, Video klub, Butik, Librari, Argjendar, Orëtar, Kozmetikë, Avokaturë, agjenci turistike, Lokal për mbajtjen e kurseve, Rrobaqepës, Këpucëtar, Fotograf, Mbathtar, Pastrim kimik, Autolarje, Parking, Internet kafe, Frizer, e të ngjashme).	Veprimtaritë e vogla dhe të mesme komerciale dhe shërbyese (Byrektore, Ëmbëltoje, Furrë e bukës, Gjellëtore, Kafeteri, Qebaptore, Shitore ushqimore, Ambulanca private, Farmaci, Ekspozitura të bankave, Shitore të tekstilit, Shitore tjera, Automekanik, Auto-elektricit, Xhamaprerës, Qendër sportive e të ngjashme)	Veprimtaritë e mëdha komerciale, shërbyese dhe ato prodhuese (Restorant, Piceri, Hotel, Motel, Supermarket, Shtypshkronja, Treg, Shkolla private, Poliklinika private, Pompa e benzinës, Depo ushqimore, Depot ndërtimore, Objekte prodhuese e të ngjashme)
Tarifa (EURO/muaj)	5.50	8.50	15.00
2.2. Shërbimet e Ofruara me Kontejnerë të Veçantë			
Vëllimi i Kontejnerit	1.1 m3	5.0 m3	7.0 m3
Tarifa (EURO/zbrazje)	9.00	25.00	n/a

3. Kategoria e Konsumatorëve Institucional			
3.1. Shërbimet e Ofruara me Kontejnerë të Përbashkët			
Nën-kategoria	<u>Nën-Kategoria 1</u>	<u>Nën-kategoria 2</u>	<u>Nën-kategoria 3</u>
	(Zyra e partive politike, zyra postare, përfaqësi të shoqatave, objekte fetare e të ngjashme).	(Shoqata, ambulanca, çerdhe, halla te sporteve, kinema, teatro, galeri e arteve, biblioteka, e të ngjashme).	(Shkolla, posta, spitale, ministri, objekte te kuvendeve komunale, institucione financiare, institucione ndërkombëtare, qendra e studentëve, shtëpi botuese, shtypshkronja, poliklinika, gjykata, stacioni i autobusëve, stacioni i trenit e ngjashme)
Tarifa (EURO/muaj)	5.50	8.50	15.00
3.2. Shërbimet e Ofruara me Kontejnerë të Veçantë			
Vëllimi i Kontejnerit	1.1 m3	5.0 m3	7.0 m3
Tarifa (EURO/zbrazje)	9.00	25.00	n/a